

REFORMA NË SISTEMIN FINANCIAR

Hormoz Aghadey
Drejtues programi, Banka Botërore

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të filloj duke shprehur kënaqësinë time që gjendem sot këtu, pas ftesës së autoriteteve shqiptare, për të përcjellë dhe përgëzuar progresin e kryer nga Shqipëria në implementimin e reformave ekonomike dhe strukturore që prej anëtarësimit të saj në

Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore dhjetë vjet më parë.

Qëllimi kryesor i ndodhjes time sot në këtë konferencë është rishikimi i progresit që ka kryer deri më sot Shqipëria në reformimin e sektorit të saj bankar dhe i përpjekjeve të saj më të fundit për reformimin e sektorit financiar jobankar.

Si fillim, do të doja të përmendja se Shqipëria konsiderohet si një nga vendet e rajonit i cili, në një kohë relativisht të shkurtër, ka arritur rezultate të dukshme në implementimin e reformave stukturore me bazë të gjerë. Megjithatë, pavarësisht nga kjo performancë e përgjithshme e mirë, Shqipëria pati një progres tepër të kufizuar drejt zhvillimit të një sistemi bankar funksional në fillimet e programit të rigjallërimit ekonomik, midis viteve 1992-1996.

VËSHTRIM MBI PERIUDHËN E PARA – 1997

Gjatë kësaj periudhe, sektori bankar ishte i paaftë të funksiononte efektivisht përse i takon ndërmjetësimin të brendshëm financiar. Bankat private, të cilat konsistonin në banka të vogla me kapital të huaj ose të përbashkët dhe pa shtrirje me degë, hezitonin të jepnin hua dhe fokusoheshin kryesisht në transaksionet e këmbimeve valutore dhe në financimin e tregtisë.

Bankat me kapital shtetëror, ishin të angazhuara në huadhënien e brendshme, por ato operonin si agjenci shtetërore me kufizime të buta në administrimin e fondeve dhe dështuan në implementimin e praktikave prudente të huadhënies.

Disa vlerësime tregojnë se, në fund të vitit 1996, huatë e këqija të bankave me kapital shtetëror përfaqësonin rreth 80 për qind të totalit të portofolit të huave të tyre.

Përveç performancës së dobët në ndërmjetësimin e kredisë, oferta e shërbimeve të tjera financiare ndaj publikut, ishte gjithashtu tepër e dobët.

Shumë nga aktivitetet financiare në ekonomi ndodhnin jashtë institucioneve financiare të licencuara, në tregun joformal financiar. Infrastruktura financiare, duke përfshirë sistemin e pagesave, të kontabilitetit dhe të kontrollit, ishte gjithashtu tepër e dobët.

Mungesa e një sistemi bankar formal funksionues, e shoqëruar nga një strukturë e pamjaftueshme e rregullimit dhe e mbikëqyrjes,

kontribuoi në lulëzimin e skemave financiare joformale. Kjo përfshinte skemat piramidale, shembja e të cilave nxiti krizën civile që shpërtheu në fillimin e vitit 1997, e cila fshiu shumë nga arritjet e realizuara në vitet e para të tranzicionit. Megjithatë, ngjarjet që ndodhën si rezultat i shembjes së skemave piramidale mund të kenë përfaqësuar një element nxitës për reformat në sektorin bankar.

RIFOKUSIMI TEK REFORMAT PAS KRIZËS SË VITIT 1997

Që prej mesit të vitit 1997, qeveria e re filloi të shpërbënte skemat piramidale me shpejtësi, me asistencën e komunitetit të donatorëve, dhe, së bashku me Bankën e Shqipërisë, afirmoi angazhimin e saj të plotë për implementimin e një programi reformash të nevojshme për sektorin bankar. Angazhimi i qeverisë së re, drejt një programi të plotë të reformave strukturore në sektorin bankar, shërbeu si instrument për rivendosjen e besimit të publikut në institucionet dhe shërbimet financiare.

Programi që qeveria ka adoptuar që prej vitit 1997, fokusohet në tre objektiva kryesorë: përmirësimin e strukturës ligjore e rregullative, ndërtimin e institucioneve të shëndosha e të besueshme dhe forcimin e infrastrukturës financiare.

Si prioritet të parë, autoritetet ndërmorën aksione të vendosura për përmirësimin e ligjeve dhe të rregulloreve të sektorit financiar dhe duhen përgëzuar për përpjekjet e tyre në këtë drejtim. Ligji për Bankën e Shqipërisë dhe ligji për bankat u miratuan, respektivisht në fund të vitit 1997 dhe në fillim të vitit 1998. Një ligj i ri për falimentimin, në harmoni me legjislacionin e ngjashëm të Bashkimit Europian, është përgatitur dhe do t'i paraqitet në një kohë të shkurtër Kuvendit për miratim. Së fundi, ligji për transaksionet e sigurta, hyri në fuqi në janar të vitit 2001.

Falë përpjekjeve të koordinuara të autoriteteve shqiptare, struktura ligjore dhe rregullative e sektorit financiar, reflekton tashmë mjaft nga standardet ndërkombëtare dhe rajonale të konsideruara si "praktikat më të mira" dhe është në përgjithësi i përshtatshëm për nivelin ekzistues të aktivitetit bankar.

Më pas, qeveria adoptoi një program për një ndryshim të shpejtë të pronësisë së bankave me kapital shtetëror, i cili çoi në likuidimin e Bankës Tregtare Agrare dhe në krijimin e një agjencie për rekuperimin e asetëve të këqija të bankave me kapital shtetëror. Bilancet e tyre u pastruan dhe bankat u përgatitën për privatizim.

Banka Kombëtare Tregtare u rikapitalizua dhe u privatizua në vitin 2000. Banka e Kursimeve do të privatizohet në vitin 2002. Me privatizimin e saj, prezenca e shtetit do të mungojë plotësisht në biznesin bankar.

Siç përmenda më parë, strategjia e qeverisë për reformat në sektorin financiar ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet e fokusuar në ndërtimin dhe në forcimin e institucioneve. Në vitin 1998, qeveria ngriti Agjencinë e Trajtimit të Kredive (ATK), për likuidimin e portofoleve të këqija të bankave me kapital shtetëror. Megjithatë, Agjencia e Trajtimit të Kredive nuk ka funksionuar efektivisht si një likuiduese agresive e aseteve. Në mënyrë që të përmirësohet performanca e saj, një ligj i ri po përgatitet dhe do të paraqitet së shpejti në Kuvend, për miratim.

Fusha e tretë e reformave në të cilën po lëviz Qeveria Shqiptare, synon forcimin e infrastrukturës financiare. Gjatë katër viteve të fundit, Banka e Shqipërisë i ka përqendruar përpjekjet e saj në përmirësimin e efektivitetit të strukturës rregullative dhe të mbikëqyrjes së sistemit bankar. Forcimi i kapacitetit mbikëqyrës është një detyrë kryesore duke njohur rolin dominues të sektorit bankar në sektorin financiar shqiptar dhe në kushtet e pritjeve për një mjedis bankar privat dinamik. Puna për përgatitjen e një plani zhvillimi institucional për mbikëqyrjen bankare, është në vazhdim. Me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe të transparencës për raportimet e rregullta nga bankat, Banka e Shqipërisë ka adoptuar një plan të ri të llogarive për bankat sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Një tjetër element i rëndësishëm i një infrastrukture financiare moderne është sistemi i pagesave. Në këtë aspekt, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar një program për vendosjen e një sistemi eficient dhe të besueshëm të Real Time Gross Settlement (RTGS).

Me mbështetjen e donatorëve, qeveria do të ndërtojë së shpejti Byronë e Informimit të Kredive (BIK). Byroja e Informimit të Kredive do të sigurojë informacion për huamarrësit aktualë dhe potencialë, duke mundësuar kështu shpërndarje në mënyrë më eficiente të burimeve për huadhënësit si dhe akses më të lehtë ndaj kredisë për sipërmarrjet e shëndetshme të biznesit. Nga ana tjetër, që prej fillimit të vitit 2001, ka funksionuar në mënyrë të kënaqshme Regjistri i Securing Charges. Kjo do të kontribuojë edhe më tej për ta bërë mjedisin më të përshtatshëm për bankingun tregtar.

Së fundi, qeveria i ka drejtuar përpjekjet e saj në zhvillimin dhe reformimin e sektorit financiar jobankar. Shqipërisë i duhen njohur

merita të veçanta për mbështetjen e saj të hershme për programet e mikrokredisë, të cilat janë ndër më të suksesshmit në rajon. Gjatë dhjetë viteve të fundit në Shqipëri, mbi 20,000 fermerë të vegjël dhe sipërmarrës të vegjël në qytet kanë përfituar hua të vogla. Normat e shqlyerjes së këtyre huave, kanë qenë tepër të larta – mbi 90 për qind – pasi mikrokredia mbështetet në presionin e të njëjtit grup dhe forma të tjera jotradicionale të kolateralit. Mikrokredia është provuar si një mjet efektiv për uljen e varfërisë dhe për zhvillimin e sektorit të vogël privat. Në vitet e fundit, qeveria po mbështet Shoqëritë e Kursimeve dhe të Kreditit, të cilat mund të jenë baza për një sistem krediti të qëndrueshëm në sektorin bujqësor. Qeveria kaloi një ligj të ri për Shoqëritë e Kursimeve dhe të Kreditit dhe Banka e Shqipërisë po punon për kompletimin e rregulloreve.

Brenda sektorit financiar jobankar, qeveria i ka drejtuar, gjithashtu, përpjekjet më të fundit drejt zhvillimit të një sektori të sigurimeve, të mbështetur mbi ligjet e tregut. Në këtë drejtim, përpjekjet e qeverisë kanë qenë deri tani të kufizuara në përgatitjen e INSIG, kompanisë së sigurimeve me kapital shtetëror, për privatizim dhe në përmirësimin e strukturës rregullative dhe mbikëqyrëse. Shumë më tepër duhet të bëhet në vitet që do të vijnë dhe qeveria po i drejtohet kësaj sfide të re me angazhim të plotë dhe me vendosmëri.

VLERËSIMI I REZULTATEVE TË REFORMAVE

Më lejoni tani të kthehem shkurtimisht drejt një vlerësimi për rezultatin e përpjekjeve të reformave dhe veçanërisht, drejt vlerësimit të ndikimit të reformave në sektorin bankar në disponimin e ndërmjetësimit financiar ndaj sektorit privat. Jam i kënaqur të raportoj se rezultatet e deritashme, kanë qenë përgjithësisht inkurajuese. Implementimi, përgjithësisht i suksesshëm, i strategjisë së reformave të qeverisë, së bashku me stabilitetin makroekonomik dhe rritjen, ka kontribuar në rivendosjen e besimit në sistemin bankar, siç evidentohet edhe nga rritja e ndjeshme në depozitat totale të publikut. Në vitin 2000, niveli i depozitave të mbajtura nga individët (229,135 milionë lekë) ishte pothuaj dy herë më i madh se niveli i vitit 1997 (118,466 milionë lekë). Përveç kësaj, nivelet e përgjithshme të ndërmjetësimit janë rritur, ndonëse duke nisur nga një bazë shumë e ulët krahasimi. Në vitin 2000, rritja e huave ndaj sektorit privat arrinte në 65.2 për qind, ndonëse niveli i tyre ishte ende i ulët. Kjo ka ardhur si rezultat i zbatimit të politikave më aktive të huadhënies, të adoptuara nga bankat tregtare private, të cilat kanë rezultuar gradualisht në

disponibilitetin e produkteve bankare më të shumëllojshme dhe në shërbime më të mira për popullsinë. Së fundi, bankat private kanë filluar të hapin degë të reja në qytetet periferike.

Konkurrenca në sistemin bankar është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Në vitin 2000, norma e rritjes së aseteve të përgjithshme, të depozitave dhe të bonove të thesarit për bankat private kapërceu ndjeshëm atë të Bankës së Kursimeve dhe të Bankës Kombëtare Tregtare të sapoprivatizuar.

Siç përmenda më parë, këto rezultate janë inkurajuese. Megjithatë, shumë më tepër nevojitet të bëhet në mënyrë që të konsolidohen arritjet e mëparshme dhe të nxitet një angazhim më i mirë i sektorit financiar në zhvillimin e ekonomisë shqiptare.

SFIDAT QË NA PRESIN

Kjo çon në çështjen time të fundit, e cila trajton të ardhmen e reformave në sektorin financiar dhe nënvizimin shkurt të masave dhe të politikave, që qeveria synon të ndjekë. Këto veprime dhe politika janë në harmoni me objektivin afatgjatë të Shqipërisë për ndërtimin e një sistemi financiar të mbështetur në rregullat e ekonomisë së tregut, që operon sipas ligjeve dhe rregulloreve të harmonizuara me parimet e Bashkimit Europian, me institucione të shëndetshme, i integruar me tregjet financiare ndërkombëtare. Një sistem financiar, i cili ka besimin e publikut dhe që mund të kontribuojë në rritjen e vazhdueshme të Shqipërisë nëpërmjet shpërndarjes efektive të burimeve. Një sistem, i cili i përgjigjet nevojave të popullsisë dhe të komunitetit të biznesit.

Përpyekjet e menjëhershme drejt këtij qëllimi do të përqendrohen, mes të tjerash, në konsolidimin e reformave në sektorin bankar, në zhvillimin e strukturave që trajtojnë falimentimin dhe shitjen, dhe në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar. Programi do të forcojë kapacitetin mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për identifikimin, matjen, monitorimin dhe administrimin e rreziqeve të bankave të veçanta dhe të sistemit si i tërë. Programi, gjithashtu, do të përmirësojë implementimin dhe zbatimin e legjislacionit mbi falimentimin dhe likuidimin e borxheve. Përsa i takon zhvillimit të mëtejshëm të sektorit financiar jobankar, strategjia e qeverisë do të përqendrohet në përmirësimin e strukturës rregullative dhe mbikëqyrëse për sektorin e sigurimeve dhe në privatizimin e INSIG. Rregulloret për mbikëqyrjen e sektorit të sigurimeve do të rishihen dhe sillen më pranë standardeve të Bashkimit Europian

dhe pavarësia e Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve Shqiptare do të forcohet më tej.

Në përpjekjet e saj për të reformuar sistemin bankar, qeveria ka kërkuar dhe ka përfituar mbështetjen e plotë të Grupit të Bankës Botërore, si edhe të donatorëve të tjerë. Në mënyrë të veçantë, Banka Botërore po asiston qeverinë në hartimin dhe në implementimin e programit të përmendur më sipër nëpërmjet Financial Sector Adjustment Credit. Në të shkuarën, Banka Botërore ka ofruar këshillim dhe asistencë ndaj sektorit financiar shqiptar nëpërmjet dy operacioneve shtesë që vazhdojnë, Projektit të Asistencës Teknike për Ndërtimin e Institucioneve të Sektorit Financiar dhe Projektit të Asistencës Teknike për Programin e Rigjallërimit.

Për të konkluduar, dëshiroj të përgëzoj autoritetet shqiptare për angazhimin e tyre në programin e reformave të sektorit financiar si dhe përpjekjet e tyre të shkuara, të cilat deri tani kanë dhënë rezultate të mira. Sigurisht, ka patur edhe ngecje gjatë këtij procesi dhe shumë më tepër sfida gjenden përpara. Megjithatë, kam besim se së bashku, ne si donatorë do të vazhdojmë të japim një kontribut të rëndësishëm në mbështetjen e Shqipërisë për ecjen përpara në axhendën e saj të reformave në sektorin financiar. Nëse do të ketë një angazhim të fuqishëm e të vazhdueshëm nga ana e autoriteteve, më lejoni t'iu risiguroj se Banka Botërore do të jetë e gatshme të vazhdojë të asistojë Shqipërinë në plotësimin e objektivit të saj final, për ndërtimin e një sistemi bankar të mbështetur mbi rregullat e tregut dhe të një sektori financiar të qëndrueshëm. Do të doja të shprehja vlerësimin tim për bashkëpunimin e shkëlqyer që kemi patur me autoritetet shqiptare në të shkuarën dhe të shpresoj se bashkëpunimi ynë i ardhshëm do të jetë njësoj i frytshëm.

Ju faleminderit !